

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE
“NËNË TEREZA” TIRANË, ME OBJEKT “AUDITIMIN E PROCEDURËS SË
ZHVILLUAR PËR TENDERIN ME OBJEKT “PËR SHËRBIMIN E LAVANDERISË
DHE HOTELERISË NË PAVIONET E QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE
“NËNË TEREZA” TIRANË” VITI 2015.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, me objekt “Auditimin e procedurës së zhvilluar për tenderin me objekt “Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavijonet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë” viti 2015”, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 31, datë 31.03.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 40/8, datë 30.04.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar znj. Ogerta Manastirliu, Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

A. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Gjetja nga auditimi.

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë” viti 2015 me procedurën “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit”, KVO ka skualifikuar padrejtësisht bashkimin e operatorëve “DD” sh.pk. kur duhej ta kualifikonte atë dhe ta shpallte fitues me ofertën 76,369,644.8 lekë pa t.v.sh. duke lidhur kontratën, pasi oferta e paraqitur prej tij është më vlerë më të ulët se oferta e paraqitur nga “A” sh.pk. prej 87,173,020,7 lekë pa t.v.sh. Diferenca prej 10,803,375,9 lekë pa t.v.sh. përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet.

S’kualifikimi i këtij operatori nga KVO-ja vjen në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9643, dt. 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 53, pika 1, në të cilën citohet se “...Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave”, si dhe me pikën 4, ku shprehet se “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”.

-VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreu V, pika 4, germa ç, sipas së cilës “Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbalin e prokurimit”, germën e, sipas së cilës “Në rastin e procedurave me negocim, me ose pa njoftim paraprak, dhe në varësi të kompleksitetit të kontratës, komisioni mund të zhvillojë negociata, në faza të ndryshme, me secilin nga kandidatët e përzgjedhur, por gjithmonë duhet të pasqyrojë përmbajtjen e tyre në procesverbalin përkatës”, dhe pikën gj, ku thuhet se “Nëse ka dyshime, autoriteti kontraktor verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga ofertuesit”.

Për sa më sipër s’kualifikimi i këtij operatorit është në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, pika 4, germa ç; “.....komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo që nuk janë me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në rregullat e prokurimit publik...”, kreu IV, pika 5, germa a, “me krijimin e nevojës ekstreme, autoriteti kontraktor duhet, njëkohësisht, të marrë

të gjitha masat për realizimin e procedurave normale të prokurimit”. Për veprimet e mësipërme në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik mban përgjegjësi KVO e përbërë nga L. S. Kryetar, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Hotelerisë, K.Q. anëtar, Specialist në Sektorin e Prokurimeve, A. T. anëtar, Specialist në Sektorin e Financës.

Niveli i prioritetit.

Vlera e mësipërme në shumën 10,803,375.9 lekë, ka nivel të lartë prioriteti dhe është me ndikim të lartë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar.

Rekomandimi.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë (administrativë, gjyqësorë e përmbarimore) në vlerën **10,803,375.9** lekë nga anëtarët e KVO dhe konkretisht:

L. S. Kryetar, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Hotelerisë, K. Q. anëtar, Specialist në Sektorin e Prokurimeve, A. T. anëtar, Specialist në Sektorin e Financës nga 3,601,125,3 lekë secili, pasi në tenderin “Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë” viti 2015, kanë s’kualifikuar padrejtësisht bashkimin e operatorëve ekonomikë “DD” sh.p.k. me vlerë oferte 76,369,644.8 lekë pa t.v.sh. në një kohë kur oferta e paraqitur prej tij, është me vlerë më të ulët se oferta e paraqitur nga “A” sh.p.k. prej 87,173,020,7 lekë pa t.v.sh. Diferenca prej 10,803,375,9 lekë pa t.v.sh. përbën dëm ekonomik, shkaktuar autoritetit kontraktor e cila duhet të arkëtohet. (trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

B. KALLËZIM PENAL

1. Nga auditimi tematik i procedurave të prokurimit për tenderin e zhvilluar me objekt “Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e Qendrës Spitalore Universitare (QSUT) “Nënë Tereza” Tiranë” viti 2015, zhvilluar nga QSUT me procedurën “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” rezultoi si më poshtë:

✓ Nga KVO është s’kualifikuar bashkimi i operatorëve “DD” sh.p.k. me ofertën 76,369,644.8 lekë pa t.v.sh. sipas procesverbalit dt. 9.01.2015, me argumentin se “Operatori “D” sh.p.k. nuk plotëson numrin mesatar të punonjësve për periudhën janar-dhjetor 2013 në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit me nr. 31 Rep. 8 kol. Dt. 7.01.2015 **konkretisht operatori “D” sh.p.k. ka marrë përsipër të kryejë shërbime në masën 59%. Ky operator në vërtetimin nr. 73138/2, dt. 8.10.2014 për kontributet e sigurimeve shoqërore shëndetësore për periudhën janar-dhjetor 2013, rezulton se ka punësuar mesatarisht 17.5 punonjës rrjedhimisht nuk plotëson numrin prej 17.7 punonjës që duhet të kishte sipas përqindjes së marrë përsipër”.**

Nga auditimi i dosjes së operatorit ekonomik “D” sh.p.k. rezultoi se për të dy vitet ka punësuar mesatarisht **17.8** punonjës e cila është në përputhje me 59% të shërbimeve të mara përsipër, sipas kontratës së bashkëpunimit me nr. 31 Rep. 8 kol. Dt. 7.01.2015.

Gjithashtu nga KVO është s’kualifikuar bashkimi i operatorëve “DD” sh.p.k. me ofertën 76,369,644.8 lekë pa t.v.sh. sipas procesverbalit dt. 9.01.2015, me argumentin se “**Operatori “DD” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën.. “operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht 30 (tridhjetë) punonjës për vitet 2013 dhe janar-nëntor 2014, sepse vërtetimi nr.**

17735/2, dt. 20.11.2014 i lëshuar nga sektori i përpunimit të deklaratave, vlerësimit dhe rimbursimit për kontributet e sigurimeve shoqërore shëndetësore për tatim paguesin nuk plotëson elementet formal të detyrueshëm të një shkrese zyrtare pasi ky vërtetim nuk është as i firmosur dhe as i vulosur nga institucioni që presupozohet që mund ta ketë lëshuar këtë vërtetim.....rrjedhimisht operatori “DD” sh.p.k. nuk plotëson këtë pikë pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriterin e mësipërm për numrin e punonjësve për periudhën janar-dhjetor 2013”.

✓ Nga auditimi i dosjes së operatorit ekonomik “DD” sh.p.k. rezultoi se operatori ekonomik ka paraqitur, vërtetimin nr. 17735/2, dt. 20.11.2014 për kontributet e sigurimeve shoqërore shëndetësore për periudhën janar-dhjetor 2013, por pa firmën dhe vulën e lëshuesit të këtij dokumenti. Gjithashtu operatori i mësipërm ka paraqitur të noterizuara listpagesat për vitin 2013 dhe për vitin 2014 deri nëntor, me punonjësit e punësuar dhe siguruar të cilat përputhen me numrin e punonjësve të pasqyruara me vërtetimet e mësipërme. Nga llogaritjet rezulton se për të dy vitet ka punësuar mesatarisht 28 punonjës e cila është më e lartë se 41% të shërbimeve të mara përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit me nr. 31 Rep. 8 kol. Dt. 7.01.2015.

Nga KVO nuk ka kërkesë drejtuar operatorit për të paraqitur, sqaruar ose vlerësuar dokumentet e paraqitura prej tij për të cilat pretendohet nga KVO se “nuk plotëson elementet formal të detyrueshëm të një shkrese zyrtare” nëse ato përmbajnë të gjithë elementët formalë dhe materiale që duhet të ketë një akt administrativ dhe nëse janë në përputhje me DST e kërkuara nga autoriteti kontraktor sipas VKM nr. 1. Datë 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa ç në të cilën thuhet “Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbalin e prokurimit”, germa e sipas së cilës “Në rastin e procedurave me negocim, me ose pa njoftim paraprak, dhe në varësi të kompleksitetit të kontratës, komisioni mund të zhvillojë negociatë, në fazë të ndryshme, me secilin nga kandidatët e përzgjedhur, por gjithmonë duhet të pasqyrojë përmbajtjen e tyre në procesverbalin përkatës” dhe pika gj, “Nëse ka dyshime, autoriteti kontraktor verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga ofertuesit”.

Gjithashtu ky operator është s’kualifikuar me argumentin sipas procesverbalit dt. 9.01.2015 se operatori “DD” sh.p.k. “Për vërtetimin e kontratave të realizuara me subjekte private operatori ka paraqitur 7 grupe lidhjesh.....të gjitha fletët e faturave të të gjitha grupeve janë të vulosura me vula lidhëse midis grupeve të pa identifikueshme dhe disa nga grupet nuk e kanë fare vulën lidhëse. Vërtetimi i noterit nuk është i lidhur me asnjë nga grupet e ndara të faturave.....”.

Nga auditimi i dosjes së operatorit ekonomik “DD” sh.p.k. rezultoi se për kontratat e realizuara me subjekte private operatori ekonomik ka paraqitur faturat tatimore me subjekte private me 7 lidhje, të shoqëruara me vulën noteriale në çdo faqe (faturë) dhe me vulën lidhëse.

Pra rezulton se nga KVO nuk ka kërkesë drejtuar operatorit për të paraqitur, sqaruar ose vlerësuar dokumentet e paraqitura prej tij për të cilat pretendohet nga KVO se “nuk plotëson elementet formal të detyrueshëm të një shkrese zyrtare” nëse ato përmbajnë të gjithë elementët formalë dhe materiale që duhet të ketë një akt administrativ dhe nëse janë në përputhje me DST e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

✓ KVO ka skualifikuar padrejtësisht bashkimin e operatorëve “D & DD” sh.pk. kur duhej ta kualifikonte atë, ta shpallte fitues me ofertën 76,369,644.8 lekë pa t.v.sh. dhe të lidhte kontratën, pasi oferta e paraqitur prej tij është më vlerë më të ultë se oferta e paraqitur nga “A” sh.pk. prej 87,173,020,7 lekë pa t.v.sh. dhe diferenca prej 10,803,375,9 lekë pa t.v.sh. përbën dëm ekonomik, shkaktuar autoritetit kontraktor e cila duhet të arkëtohet.

✓ Autoriteti Kontraktor dhe konkretisht KVO në klasifikimin e ofertave ka vepruar në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9643, dt. 20.11.2016 “Për prokurimin publik” neni 53, pika 1, “...Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave”, pika 4, “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”.

-VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa ç: “Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbalin e prokurimit”, germa e; “Në rastin e procedurave me negociim, me ose pa njoftim paraprak, dhe në varësi të kompleksitetit të kontratës, komisioni mund të zhvillojë negociata, në faza të ndryshme, me secilin nga kandidatët e përzgjedhur, por gjithmonë duhet të pasqyrojë përmbajtjen e tyre në procesverbalin përkatës”, pika gj; “Nëse ka dyshime, autoriteti kontraktor verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga ofertuesit”.

-VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa ç: “.....komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo që nuk janë me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në rregullat e prokurimit publik....”, kreu IV, pika 5, germa a, “me krijimin e nevojës ekstreme, autoriteti kontraktor duhet, njëkohësisht, të marrë të gjitha masat për realizimin e procedurave normale të prokurimit”. (trajtuar më hollësisht në procesverbalin dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

-Bazuar në nenin 280,281 të K.Pr.P. kërkojmë, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, fillimin e procedimit penal për konsumin e veprës penale **shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike**, të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, në ngarkim të:

- L. S.**, kryetar KVO me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Hotelerisë,
- K. Q.**, anëtar KVO, me detyrë Specialist në Sektorin e Prokurimeve,
- A. T.**, anëtar KVO, me detyrë Specialist në Sektorin e Financës.

të cilët në përmbushje të detyrave të tyre funksionale kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjin të cituar më lart duke **shkelur barazinë e pjesëmarrësve në tendera** dhe sjellë si pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik në vlerën 10,803,375,9 lekë pa t.v.sh.

C. TË TJERA

Për të mos influencuar në procedurën e prokurimit që po zhvillohet aktualisht për gjithë vitin, përcjellja e rekomandimeve dhe kallëzimi penal do të evadohen një ditë mbas përfundimit të procedurës së prokurimit “Për shërbimin e lvanterisë dhe hotelerisë në pavionet e QSUT” Tiranë.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Miranda Haxhia dhe Bexhet Zeqiri, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Departamentit.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT